

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë rrëzon Erion Veliajn, reagon Rama: Në burg pa prova për rrezikshmëri, rast unikal! Tiran a mbeti përsëri pa kokë!
ADRESA	https://versus.al/live-updates/gjykata-e-larte-le-ne-qeli-kryebashkiakun-erion-veliaj-re-agon-rama--i46578
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:46:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	86058da2c0945ef8b3af4c96f0ea491df4ec114768d89b7320b7002ca859bc34
TEKSTI	b826b8882bb00ceed58e01e311231ed356a3a3c289f3b7009a600dfe7f8f0f1f
PAMJA	a2c671c35068d25158e7408651835a2e2e1ffad9f34fdf83ac36a03cb2294b18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86602d5f5d605c9efee2ebd19c0be1559c67604b9ce7f1958b357a0bc26115d4
E MËPARSHMJA	c76c189df1384d06e855e2ab5ff0e77f7ffe98e573cfd122a7c97f9ee89c2221
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/86602d5f5d605c9efee2ebd19c0be1559c67604b9ce7f1958b357a0bc26115d4

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

Gjykata e Lartë rrëzon Erion Veliajn, reagon Rama: Në burg pa prova për rrezikshmëri, rast unikal! Tirana mbeti përsëri pa kokë!

15 Shtator 2026, 11:18

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 15 Shtator 2026, 11:18

Gjykata e Lartë rrëzon Erion Veliajn, reagon Rama: Në burg pa prova për rrezikshmëri, rast unikal! Tirana mbeti përsëri pa kokë!

*Gjykata e Lartë vendosi sot lënien në fuqi të masës së 'arrestit me burg' për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj i cili mbahet në paraburgim që prej shkurtit të vitit 2025. *Pas dhjetëra artikujve ku flitej për mundësinë e lirimit të Veliajt, pas disa orësh në Dhomën e Këshillimit, gjykata hodhi poshtë mundësinë e ndryshimit të masës së sigurisë pavarësisht se Gjykata Kushtetuese e kishte cilësuar masën si "jo proporcionale". *Gjatë kohës që gjyqtarët po merrnin në shqyrtim çështjen, jashtë godinës së gjykatës së Lartë pati protesta nga qytetarët të cilët kërkonin që Veliaj të mbetej në burg. Për vendimin e sotëm, reagoi dhe kryeministri Edi Rama i cili tha se lënia e kryetarit të bashkisë në burg dhe pse s'ka prova se është i rrezikshëm, është rast unikal në Evropë



Shkruar nga Versus

Çfarë do të gjeni në brendësi

*Gjykata e Lartë vendosi sot lënie në fuqi të masës së 'arrestit me burg' për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj i cili mbahet në paraburgim që prej shkurtit të vitit 2025. *Pas dhjetëra artikujve ku flitej për mundësinë e lirimit të Veliajt, pas disa orësh në Dhomën e Këshillimit, gjykata hodhi poshtë mundësinë e ndryshimit të masës së sigurisë pavarësisht se Gjykata Kushtetuese e kishte cilësuar masën si "jo proporcionale". *Gjatë kohës që gjyqtarët po merrnin në shqyrtim çështjen, jashtë godinës së gjykatës së Lartë pati protesta nga qytetarët të cilët kërkonin që Veliaj të mbetej në burg. Për vendimin e sotëm, reagoi dhe kryeministri Edi Rama i cili tha se lënia e kryetarit të bashkisë në burg dhe pse s'ka prova se është i rrezikshëm, është rast unikël në Evropë

5 Postime
43 MINUTA ME PARE

“Përsëri Tirana pa kokë”, Rama reagon pas vendimit për Erion Veliajn: Kalvari i kryebashkiakut është unikël në historinë e Europës



Kryeministri Edi Rama reagon pas vendimit të Gjykatës së lartë që la në qeli kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj.

Në mesazhin e tij, Rama thotë se ai nuk komenton vendimin e gjykatës, por kalvari i Erion Veliajt është unikël në historinë e Europës demokratike.

Sipas tij, nuk ka prova që vërtetojnë rrezikshmërinë ekstreme të Veliajt, e cila mund të arsyetojë kycjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli.

"Por, përtej faktit që kalvari i Erion Veliajt është unikël në historinë e Europës demokratike dhe gjithashtu faktit që ende nuk shihet gjekundi prova e rrezikshmërisë ekstreme, e cila mund të arsyetojë kycjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli, ka një të vërtetë tjetër të hidhur: Askush s'po do t'ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thujse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thujse 1 milionë banorë duhet t'i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik", shkruan Rama.

Mesazhi i plotë

"Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtaz nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq!

Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nëshetrohem gjithnjë këtij rregulli - madje as nuk i komentoj vendimet përpara formës së prerë. Por, përtej faktit që kalvari i Erion Veliajt është unikël në historinë e Europës demokratike dhe gjithashtu faktit që ende nuk shihet gjekundi prova e rrezikshmërisë ekstreme, e cila mund të arsyetojë kycjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli, ka një të vërtetë tjetër të hidhur: Askush s'po do t'ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thujse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thujse 1 milionë banorë duhet t'i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik./Versus.al

Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtaz nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq! Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nëshetrohem gjithnjë këtij rregulli - madje as nuk i komentoj vendimet përpara formës së prerë. Por, përtej faktit që kalvari i Erion Veliajt është unikël në historinë e Europës demokratike dhe gjithashtu faktit që ende nuk shihet gjekundi prova e rrezikshmërisë ekstreme, e cila mund të arsyetojë kycjen e pambarimtë në qeli të një të zgjedhuri nga populli, ka një të vërtetë tjetër të hidhur: Askush s'po do t'ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thujse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thujse 1 milionë banorë duhet t'i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik.

— Edi Rama (@ediramaal) September 15, 2026

3 ORE ME PARE

Veliaj u la në burg, mbrojtja e kryebashkiakut për vendimin e Gjykatës së Lartë: Jashtëzakonisht shqetësues





Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për lënie në burg të Erion Veliaj, ka reaguar avokati i kryebashkiakut. Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, Plarent Ndreca e cilësoi vendimin "jashtëzakonisht shqetësues" duke pretenduar se ishin shkelur garancitë kushtetuese.

Ndërsa shtoi se do të vijojë përpjekja me çdo mjet juridik për lirimin e Veliaj.

"Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, qytetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur. Z. Erion Veliaj prezumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim.

E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojnë dhe t'i kufizojnë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes "lawfare"-it.

Në do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare.

*Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin"- shkruan Ndreca. **Versus.al***

5 ORE ME PARE

Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn



Gjykata e Lartë ka vendosur mosndryshimin e masës 'arrest me burg' për kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj.

Çështja e Veliajt u rikthye në Gjykatën e Lartë nga Gjykata Kushtetuese e cila e konsideroi masën e sigurisë ndaj tij si "jo proporcionale".

Teksa gjyqtarët merrnin vendimin në Dhomë Këshillimi, jashtë gjykatës dhjetëra qytetarë kërkuan mosndryshimin e masës së sigurisë për Veliajn. Ndërkohë përgjatë ditëve të fundit, në media kanë qarkulluar artikuj ku pretendohet se gjyqtarët do të merrnin vendimin për lirimin e Veliajt.



Kryebashkiaku i Tiranës mbahet në paraburgimin e Durrësit që prej 10 shkurtit të vitit 2025 nën 13 akuza për 5 vepra penale. Ai nuk ka pranuar të shkojë as në seancat gjyqësore që mbahen në GJKKO për dosjen e tij. **Versus.al**

5 ORE ME PARE

"O gjykatës bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli", qytetarët protestojnë para Gjykatës së Lartë



Dhjetëra qytetarë janë mbledhur para godinës së gjykatës së Lartë mëngjesin e sotëm teksa në Dhomë Këshillimi shqyrtohet kërkesa e Erion Veliajt për ndryshimin e masës së sigurisë.

Me thirrjet "o gjyqtar bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli", qytetarët shprehën qëndrimin e tyre kundër polemikave dhe artikujve të shpërndarë në rrjetet sociale ku flitet për një skemë të mundshme të lirimit të kryebashkiakut.

Që prej orës 09:30 ka nisur seanca në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë. **Versus.al**

8 ORE ME PARE

Nën 13 akuza për 5 vepra penale, sot Gjykata e Lartë vendos për fatin e Erion Veliajt





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.